



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 mars 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W04571
nëpërmjet Videokonferencës**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(2) dhe (4)(f), 23(1) dhe 40(2) të Ligjit Nr. 05/L- 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 141(1) dhe 144 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 12 mars 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi kërkesë ("Kërkesa")¹, ku kërkon autorizimin e Trupit Gjykses që dëshmitari W04571 të dëshmojë nëpërmjet videokonferencës nga një vend i përshtatshëm.² ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses duhet ta miratojë Kërkesën, pasi ajo është e domosdoshme dhe nuk do të rezultonte në dëm të papërligjur ndaj të akuzuarve.³
2. Më 13 mars 2024, në pajtim me një urdhër të Trupit Gjykses për parashtrime të përshpejtuar ("Urdhri"),⁴ Mbrojtja e Hashim Thaçit bëri të ditur se nuk e kundërshton Kërkesën, ndërsa tre ekipet e tjera të Mbrojtjes bënë të ditur se nuk kanë ndërmend t'i përgjigjen kërkesë.⁵
3. Më 14 mars 2024, në pajtim me Urdhrin, Zyra Administrative dorëzoi vlerësimin e vet paraprak ("Vlerësimi i Zyrës Administrative")⁶ duke u shprehur se dhënia e dëshmisë nga W04571 nëpërmjet videokonferencës është e realizueshme.⁷

¹ F02175, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmi nga W04571 nëpërmjet Videokonferencës*, 12 mars 2024, konfidenciale (një version i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F02175/RED), me Shtojcat 1-3, konfidenciale.

² Kërkesa, para. 1, 12.

³ Kërkesa, para. 2, 7-9.

⁴ CRSPD451, *Mesazh Elektronik i Trupit Gjykses II dërguar NJAGJ-së në lidhje me F02175 ("CRSPD451")*, 12 mars 2024, konfidencial.

⁵ CRSPD451.

⁶ F02177, *Administratorja, Vlerësim i Zyrës Administrative lidhur me Kërkesën e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmi nga W04571 nëpërmjet Videokonferencës*, 14 mars 2024, konfidencial dhe *ex parte* (një version konfidencial i redaktuar u dorëzua po atë ditë, F02177/CONF/RED).

⁷ Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 11, 21.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Në pajtim me rregullën 141(1), në parim, dëshmitarët e japin dëshminë e tyre në gjyq duke qenë të pranishëm. Trupi Gjykues gjithashtu mund të lejojë dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës sipas rregullës 144 në një mënyrë që nuk shkakton padrejtësi, apo që nuk është mospërputhëse me të drejtat e të akuzuarit.
5. Në pajtim me rregullën 144(2), Trupi Gjykues, me ndihmën e Administratorit, merr masat që vendi i zgjedhur për dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës të jetë i përshtatshëm për dhënien e dëshmisë me vërtetësi dhe në mënyrë të hapur dhe të garantojë sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitari.
6. Në pajtim me rregullën 144 (1) dhe (3), Trupi Gjykues mund të urdhërojë që dëshmia të jepet përmes videokonferencës, me kusht që nëpërmjet kësaj mënyre dëshmitari të pyetet si duhet. Trupi gjykues duhet të garantojë që videokonferenca t'u mundësojë palëve dhe trupit gjykues t'i bëjnë pyetje dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë.

III. DISKUTIM

7. Trupi Gjykues rikujton se, në pajtim me rregullën 144, Trupi Gjykues ka të drejtën të autorizojë dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës kur plotësohen kriteret e asaj rregulle, megjithëse prania e dëshmitarit në gjyq mbetet opsioni i preferuar.⁸

⁸ *Shih p.sh.* F01910, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W01493 nëpërmjet Videokonferencës*, 8 nëntor 2023, konfidencial (një version i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F01910/RED), para. 12; F01776, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W03827 nëpërmjet Videokonferencës*, 8 shtator 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 1 nëntor 2023, F01776/RED), para. 12; F01558, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dëshmi përmes Videokonferencë dhe për Masë të Posaçme për W04337-ën*, 26 maj 2023,

8. Kur bën vlerësimin nëse do ta lejojë dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës sipas rregullës 144, Trupi Gjykues mund të shqyrtojë një sërë faktorësh si “vendndodhjen, situatën personale dhe gjendjen shëndetësore, disponueshmërinë dhe sigurinë e dëshmitarit, si dhe kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e masave logjistike të udhëtimit dhe përgatitje të tjera që duhen bërë”.⁹ Në përgjithësi, mosgatishmëria e një dëshmitari për të udhëtuar në Hagë për të dëshmuar në sallën e gjyqit nuk përbën arsye të mjaftueshme për pranimin e një kërkesë të tillë. Është përgjegjësi e palës thirrëse të marrë masat që dëshmitari të paraqitet në sallën e gjyqit në Hagë për të dëshmuar.¹⁰

9. Lidhur me Kërkesën, ZPS-ja parashtroi se, për shkak të rrethanave familjare, W04571 ka nevojë për ndihmë dhe nuk ka mundur të gjejë dikë që mund të udhëtojë bashkë me të për t'i ofruar mbështetje.¹¹ Rrjedhimisht, sipas ZPS-së, dhënia e dëshmisë nga Kosova përmes videokonferencës është e domosdoshme për garantimin e mirëqenies fizike dhe psikologjike të W04571-shit.¹² Për më tepër, Zyra Administrative parashtroi se është në gjendje ta realizojë videokonferencën për W04571-shin,¹³ i cili mund të dëshmojë që më 20 mars 2024.¹⁴ Zyra Administrative më tej parashtroi se vendi i zgjedhur përputhet plotësisht me kriteret e rregullës 144(2).¹⁵

10. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të Kërkesës dhe duke mos pasur kundërshtim nga ana e Mbrojtjes, Trupi Gjykues është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar se rrethanat

rreptësisht konfidencial dhe ex parte (një version konfidencial i redaktuar u dorëzua më 30 maj 2023, F01558/CONF/RED), para. 16; KSC-BC-2020-07, Transkripti i seancës, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 2-5.

⁹ KSC-BC-2020-07, Transkripti i seancës, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 6-10. Shih, për ngjashmëri KSC-BC-2020-04, F00482/RED, Trupi Gjykues I, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Dëshmi nëpërmjet Videokonferencës për TW4-04-ën, TW4-10-ën dhe TW4-11-shin, 13 prill 2023, para. 13-14.

¹⁰ F01975, Trupi Gjykues, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W01140 nëpërmjet Videokonferencës, 1 dhjetor 2023, para. 7.

¹¹ Kërkesa, para. 7, 10.

¹² Kërkesa, para. 7-8, 10.

¹³ Vlerësimi i Zyrës Administrative, në veçanti para. 17.

¹⁴ Kërkesa, para. 2, 10.

¹⁵ Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 13.

familjare të W04571-shit, siç shpjegohet plotësisht në versionin konfidencial të Kërkesës, do të shkaktonin vështirësi në lidhje me udhëtimin e tij në Hagë për të marrë pjesë në gjykim. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se lejimi i W04571-shit për të dhënë dëshmi përmes videokonferencës nga Kosova është më i favorshëm për mirëqenien e tij sesa transferimi i tij në Hagë për të dhënë dëshmi në sallën e gjyqit.

11. Për më tepër, Trupi Gjykses i jep shumë rëndësi faktit që Mbrojtja nuk e kundërshton Kërkesën, as nuk parasheh shkeljen e të drejtave të të akuzuarve në këtë drejtim. Trupi Gjykses, të akuzuarit, palët dhe pjesëmarrësit do të mund të shohin dhe dëgjojnë dëshmitarin duke dëshmuar në kohë reale dhe do të kenë mundësinë t'i bëjnë pyetje dëshmitarit.

12. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme miratimin e Kërkesës.

13. Trupi Gjykses thekson se, pas vendimit të Trupit Gjykses¹⁶, vlerësimi përfundimtar do të bëhet nga Zyra Administrative Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses inkurajon Zyrën Administrative të punojë me shpejtësi për të siguruar marrjen e masave të nevojshme pa vonesë për ta bërë vendin e propozuar të përshtatshëm për dhënien e dëshmisë me videokonferencë dhe për t'i raportuar Trupit Gjykses pasi të jenë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e videokonferencës.

¹⁶ Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 18, 20.

IV. VENDIMI

14. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **AUTORIZON** W04571-shin të dëshmojë nëpërmjet videokonferencës;
dhe
- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të marrë masat e nevojshme për realizimin e dëshmisë së W04571-shit nëpërmjet videokonferencës dhe t'i raportojë Trupit Gjykues, palëve dhe pjesëmarrësve siç përshkruhet në paragrafin 12 të këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 15 mars 2024

Në Hagë, Holandë.